



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**LEGJISLATURA V**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**  
**Mbledhja nr. 55.**

**Prishtinë, më 4.10.2016 në orën 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Mufera Shinik, Kimete Bytyqi, Fisnik Ismaili, Milka Vuletiq, Sasha Milosavleviq, Slavko Simiq, Cerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

**Munguan:** Jasmina Zhivkoviq, Agim Çeku dhe Ali Berisha .

**Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje :** Senad Karaahmetovic përfaqësues i OSBE-së, Artan Murati përfaqësues i KDI-së, Zijush Ahmeti -konsulltant i Sekretariatit të KKK dhe Celal Iliaz- Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Mufera Sinik**, zëvendëskryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.7.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare, me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infstrukturë, Tregti dhe Industri;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

**Kryesuesja**, hodhi në votim rendin e ditës dhe pasi nuk pat propozime konkrete, konsideron se miratohet rendi i ditës, pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.7.2016;**

**Mufera Sinik -zëvendëskryesuesja**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 13.7.2016, pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare, me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**

**Nënkryetarja**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

*Me që nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:*

#### **Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-110 për kamatëvonesat në transaksionet tregtare dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

#### **4. Të ndryshme.**

**Qerim Bajrami**, dha propozim konkret që sa më parë të inicohet çështja e hapjes së drejtimit ekonomik në gjuhën boshnjake në Universitetin “Ushkin Hoti” në Prizren, për vitin akademik 2016/2017. Përkatesisht të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me akreditimin e këtij drejtimi.

Lidhur me këtë çështje kërkoi të marr përkrahjen e plotë nga komisioni me qëllim që të dalim me rekomandim, të bazuar në vendimin e Kuvendit lidhur me miratimin e amendamentit në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2016 dhe i njëjti të adresohet në MASHT dhe Rektoratin e Univerzitetin ‘Hasan Prishtina’ në Prishtin.

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pajtohen në formë unanime dhe nxorri këtë:

#### **R E K O M A N D I M**

I rekomandohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, që të ndërmerr të gjitha masat e rregullsisë për implementimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 05/L-071 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 i cili është në fuqi, Vendimit të Kuvendit të Kosovës dhe të Kërkesave të datës 26.09. dhe 4.10.2016 të dërguar nga ana e deputetit Qerim Bajrami i Duda Balje.

#### **Arsyetim**

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar amendamentin për Projektligjin nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 me të cilin ndahen dhe destinohen mjete në shumë prej 50.000 € për kategorinë ekonomike Paga dhe mëditje si dhe mjete plotësuese për Universitetin „Ushkin Hoti” të Prizrenit në Gjuhën Boshnjake.

Duke marrë parasysh autorizimet e MASHT-it është e domosdoshme angazhimi i plotë dhe urgjent për realizimin e zbatimit të kësaj çështjeje të rëndësishme për komunitetin Boshnjak dhe shoqërinë Kosovare në përgjithësi.

**Veton Berisha**, propozoj që në takimin e radhës, komisioni të caktojë si pikë e veçantë, nismën për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila ka të bëjë me amandamentimin e nenit 5.5, që të shtohet ‘24 Qershor’, si festë Memoriale për komunitetin Egjiptian.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pajtohet në formë unanime dhe nxorri këtë:

### **Përfundim**

Me datë 19.10.2016, të mbahet mbledhja e Komisionit, me temën: Inicimi i Komisionit për nismën legislative për plotësim dhe ndryshim të Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës.

**Danush Ademi**, theksoi se RTK-ja transmeton program publik nga një orë në ditë në gjuhën e komuniteteve tjera joshumicë, ndërsa sigurohen vetëm 15 minuta në javë për komunitetin ashkali. Kjo dëshmon se disa komunitete i gëzojnë të drejtat e plota, ndërsa anashkalohen të drejtat e një komuniteti.

Ai sugjeroi që në emër të Komisionit të drejtohem me shkresë RTK-së dhe Bordit të RTK-së me kërkesë që të sigurohet emitim i programit në baza ditore për shpërndarje nga 15 minuta në gjuhën e komunitetit ashkali. Në këtë mënyrë do të realizohen programet në mediat elektronike për të gjitha komunitetet.

Nënkryetarja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pajtohet në formë unanime dhe nxorri këtë:

### **R E K O M A N D I M**

Rekomandohet që Bordi i RTK-së në skemën programore për gjuhët e komuniteteve të tjera të Kosovës, në baza ditore dhe për të siguruar shpërndarjen e pesëmbëdhjetë minuta (15 minuta) e transmetimit të programit në favor të komunitetit ashkali, në pajtim me nenin 7, paragrafi 1.8 dhe 1.9, neni 8, paragrafët 3 dhe 4, neni. 29, paragrafi 2.5 dhe 2.8 të Ligjit për RTK-në në fuqi.

**Veton Berisha**, në fund doli me kërkesë që pas përfundimit të mbledhjes, të takohet GP, lidhur me çështjen e monitorimit të Ligjit për Shrbimin Civil të Republikës së Kosovës ( gjegjlsisht neni 11), me qëllim që të hartohen rekomandimet dhe të inkorporohen në raport ku në periudhën më të afërt do të procedohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:15**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Zëvendëskryetare e Komisionit**

---

**Mufera Shinik**